

## Beloderm



**Principi aktiv** - Betamethasone dipropionate 05 mg/1mg

**Forma:** Pomadë

**Sasia** :Beloderm 15gr

Betamethasone dipropionate është një glucokortikoid sintetik, i cili vepron duke penetruar dhe duke u lidhur me proteinat citoplazmatike duke shkaktuar një ndryshim strukturor në kompleksin e receptorit steroid. Ky ndryshim strukturor lejon migrimin e tij në bërthamë dhe më pas lidhjen e tij me zonën specifike të ADN e cila çon në transkriptimin e m-ARN specifike e cila rregullon sintezën e proteinave. Ai shpreh një veprim shumë selektiv glucokortikoid. Gjithashtu stimulon enzimat e nevojshme për të ulur përgjigjen inflamatore.

*Bari shpreh veti anti-inflamatore dhe imuno supresore si:*

- 1- indukton lipokortinat në makrofage, endotel, dhe fibroblastet të cilët inhibojnë fosfolipazën A2 dhe kështu ulin prodhimin e prostaglandinave, leukotrieneve, dhe faktorin aktivizues të trombociteve.
- 2- shkakton rregullim negativ të gjeneve të citokinave në makrofaget, qelizat endoteliale dhe limfocitet dhe kjo ul prodhimin e interleukinave ( IL1,2,3,6) TNF-alfa, GM-CSF( faktorin stimulus re kolonisegranulocitare makrofageale)
- 3- ul prodhimin proteinave të fazes akute nga makrofaget dhe qelizat endoteliale dhe ndikon në funksionin e komplementit.
- 4- ul prodhimin e molekulës së adezionit endothelial të limfociteve-1 ELAM-1 dhe qelizën e adezionit intraqelizor.
- 5- ndalon IG-et e ndërmjetësuar nga histamina
- 6- ul prodhimin e kolagenazave dhe stromolizinës duke ndaluar shkatërrimin indor.

### **Farmakokinetika:**

Absorbohet në qarkullimin sistematik në varësi të fuqisë dhe të sasisë së aplikuar dhe në varësi të lëkurës dhe vendit të aplikimit. Absorbimi rritet në sajë të dëmtimit të lëkurës, inflamacionit ose të okluzionit.

**Efektet anësore:**

- 1- Hollim i lëkurës
- 2- Humbje e elasticitetit
- 3- Shtim i rritjes së flokëve
- 4- Akne në vendin e aplikimit
- 5- Depigmentim i mesëm
- 6- Rosacea

**Kundër indikimet:**

1. Hipersensitiviteti ndaj betamethasonit
2. Infeksionet bakteriale dhe fungale të patrajuara
3. Akne vulgaris
4. Dermatiti perioral
5. Tuberkulozi i lëkurës
6. Ulcera varikoze
7. Dëmtimet e lëkurës të shkaktuara nga infeksionet me herpes simplex ose varicella, funge, dhe bakteret.
8. Lupusi eritematos Diskoid

**Indikacionet:**

1. Ekzema
2. Psoriasis
3. Dermatiti i kontaktit
4. Pruriti anal dhe vaginal
5. Inflamacioni i lëkurës

**Dozimi:**

Aplikohet një shtresë e lehtë 1-2 herë në ditë